



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 16.6.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Adem Salihaj, Lahi Brahimaj, Murat Hoxha.

Mungoi : Srdjan Popovic, Shaip Muja, Salih Salihu, Haxhi Shala.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 27.5.2015,
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për shërbimet e ujit,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.5.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për shërbimet e ujit

Kryetari njoftoi përkatësisht rikujtoi komisionin rreth punës së bërë gjatë hartimit të këtij ligji pranë këtij komisioni dhe ftoi komisionin që të deklarohej rreth përcjelljes për leximin e parë, pasi që i njëjti ka qenë në Qeveri për mendim dhe është kthyer pa ndonjë vërejtje.

Adem Salihaj ishte i mendimit që të procedohet në leximin e parë dhe pastaj të shikohet nga komisioni a ka nevojë për ndonjë plotësim shtesë apo rekomandim.

Murat Hoxha potencoi se gjatë hartimit të këtij ligji në grupin punues ka pasur disa vërejtje të cilat i ceku dhe shtoi se janë të rëndësishme ndoshta jo primare por gjithsesi të rëndësishme.

Lahi Brahimaj dhe anëtarët e pranishëm u pajtuan unanimisht të dërgohet projektligji në leximin e parë për miratim në parim.

4..Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Adem Salihaj** kërkoi angazhimin e komisionit rreth hartimit të rekomandimeve edhe për çështjen e misrit pasi që bëhet fjalë për vitin 2013 dhe kjo pjesërisht është shqyrtuar gjatë punës së komisionit rreth rekomandimeve për cilësinë e grurit të importuar, i cili angazhim i komisionit ka qenë mjaft frytdhënës.

Fikrim Damka theksoi se në komision ka filluar një tjetër monitorim rreth ujit dhe ndotjes së mjedisit ku kryesues është Shaip Muja, ndaj do të ishte ndoshta edhe ngarkesë për komisionin dhe zgjerim që do të shkaktonte joefikasitet, pos kësaj, vazhdoi ai, duhet ndoshta të mirën parasysh sugjerimet e stafit civil që monitorimi të bëhet tjera herë nga Kuvendi duke themeluar komision hetimor e jo kështu si ka ndodhur në këtë komision. Ai pyeti z. Adem, nëse hulumtohet misri nga komisioni, çka mund të rekomandojmë.

Adem Salihaj : unë kamë dëgjuar për ato ndërhyrje të stafit civil, por mund të them që ata nuk kanë të drejt të mirën me çështjet çka mund të monitoron politika, ne jemi ata që vendosim me kryesinë e kuvendit çka mundemi me monitoru. Pos kësaj, vazhdoi ai, ky komision ka kapacitete të vazhdoi edhe me hulumtimin e misrit dhe për një muaj do të kryente edhe këtë çështje shumë të rëndësishme, përfundoi.

Lahi Brahimaj ju rikujtoi diskutuesve që kemi probleme edhe me prodhime qumështore, ndaj si mundet ky komision të anashkaloj edhe këtë problematikë.

Murat Hoxha kërkoi pos tjerash edhe Ligjin e kadastrit për monitorim në gjysmën e dytë të vitit.

Fikrim Damka sugjeroi një mbledhje për javën e radhës kur do të revidohet plani i punës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka